

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6638
E premte, 24 qershor 2022
çmimi 0.40 €

Vizitë familjeve të çlirimtarëve! 1 FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NË SAMITIN BE - BALLKANI PERËNDIMOR NË BRUKSEL, TEMË DISKUTIMI EDHE LIBERALIZIMI I VIZAVE PËR KOSOVËN

DEKLARATA POZITIVE PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE, POR ASGJË KONKRETE

1 FAQE 4-5



Në selinë e Bashkimit Evropian (BE) është mbajtur të enjten Samiti BE - Ballkani Perëndimor. 27 krerë shtetesh dhe qeverish evropiane kanë diskutuar me kolegët e tyre nga rajoni mbi sfidat me të cilat përballesh së bashku. Temë diskutimi ishte edhe liberalizimi i

vizave për Kosovën. Shumë liderë janë shprehur në favor të kësaj çështjeje. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pas përfundimit të samitit, ka bërë me dije se këtë herë ka pasur më shumë deklarata mbështetëse për liberalizimin e vizave sesa më parë

AKTUALE



OBSH-ja E KONSIDERON SHPALLJEN E LISË SË MAJMUÑEVË 'EMERGJENCË GLOBALE' F. 2

NASER PAJAZITAJ DËNOHET ME BURGIM TË PËRJETSHËM PËR VRASJEN E DONJETËS F. 7

NGA MUAJI I ARDHSHËM PRITET TË ZGJEROHET SKEMA PËR SHITESAT E FËMIJËVE TË LINDUR PARA 2015-s F. 5

EKONOMI



MIRATOHET RISHIKIMI I BUXHETIT TË KOSOVËS PËR VITIN 2022 F. 8

SYTË KAH SERBIA PËR KTHIMIN E BORXHIT TË RRYMËS F. 8

SPORT



KOSOVA PËRMIRËSON POZITËN NË RENDITJEN E FIFA-S, SHQIPËRIA NUK NDRYSHON POZICION F. 10



DEPUTETËT NUK E MBËSHTETIN TËRHEQJEN E MJETEVE NGA TRUSTI

KA NDËRRUAR JETË PRODUCENTJA DHE REGJISORJA VJOSA BERISHA



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania e Madhe vendos sanksione të reja ndaj Rusisë

LONDËR, 23 QERSHOR - Britania e Madhe ka paraqitur një paketë të re sanksionesh financiare dhe tregtare ndaj Rusisë pas pushtimit të paprovokuar të fqinjës së saj, Ukrainës. Në njoftimin e publikuar në faqen zyrtare të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar më 23 qershor, nënvizohen kufizimet e reja, që përfshijnë një bllokim të eksporteve të mallrave dhe pajisjeve teknologjike, eksportin e karburanteve për avionët dhe përdorimin e paundëve dhe euros në Rusi. Në listën e produkteve të ndaluara përfshihen mallrat dhe pajisjet teknologjike që mund të përdoren për prodhimin e armëve biologjike dhe kimike, produkte dhe teknologji shtesë të rafinimit të naftës, si dhe produkte dhe teknologji kritike të industrisë. Vendimi ndalon importin,

blerjen ose furnizimin dhe dërgimin e mallrave me origjinë ose që dërgohen nga Rusia që mund të gjenerojnë të ardhura. Gjithashtu, parashikohen kufizime të mëtejshme për ofrimin e asistencës teknike, shërbimeve financiare, fondeve dhe shërbimeve të ndërmjetësimit në lidhje me importet e hekurit dhe çelikut. Sanksionet imponojnë kufizime për importin, blerjen ose furnizimin dhe shpërndarjen e mallrave që gjenerojnë të ardhura që kanë origjinën ose dërgohen nga Rusia, si dhe asistencën teknike, shërbimet financiare, fondet dhe shërbimet e ndërmjetësimit. Disa nga masat e reja kufizuese zbatohen si për territoret e Rusisë, po ashtu edhe ato të Ukrainës që ndodhen nën kontrollin e separatistëve të mbështetur nga Moska.



OBSH-ja e konsideron shpalljen e lisë së majmunëve 'emergjencë globale'

Gjenevë, 23 qershor - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) do të vendosë të enjten nëse do ta shpallë linë e majmunëve një emergjencë shëndetësore globale, duke nxitur kritika nga shkencëtarët afrikanë që shprehen se kjo sëmundje përbën prej vitesh një krizë shëndetësore në kontinentin e tyre. Diskutimet dhe shqyrtimi i përgjigjes së OBSH-së ndaj shpërthimit të sëmundjes pasojnë me shqetësimet se si agjencia e Kombeve të Bashkuara dhe qeveritë në mbarë botën trajtuan Covid-19 në fillim të vitit 2020. Një "emergjencë e shëndetit publik me shqetësim ndërkombëtar" është niveli më i lartë i alarmit të OBSH-së. Agjencia nuk deklaroi pandemi, por filloi ta përdorë termin për ta përshkruar Covid-19 në mars të 2020-s. Për shumë qeveri në mbarë botën, ky moment ishte çasti kur ata filluan të ndërmermin masa për ta përmbajtur sëmundjen,



çka rezultoi të ishte tepër vonë për të bërë ndryshim. Lija e majmunëve nuk përhapet aq shpejt sa Covidi dhe për këtë sëmundje ekzistojnë tashmë vaksina dhe medikamente për trajtimin e saj, por sërish ka rritur alarmin në mbarë botën.

Numri i të prekurve jashtë kontinentit afrikan ka arritur në 3 000 raste në më shumë se 40 vende, sipas agjencisë "Reuters", më së shumti midis meshkujve që kryejnë marrëdhënie me meshkuj. Ende nuk ka raportime për raste vdekjeje.

Sëmundja virale, e cila shkakton simptoma të ngjashme me gripin dhe acarim të lëkurës, është përkufizuar si endemi në disa pjesë të Afrikës. Kontinenti ka regjistruar rreth 1 500 raste të dyshuara që nga fillimi i vitit 2022, nga të cilat 66 prej tyre kanë rezultuar me pasojë vdekjen, sipas të dhënave zyrtare. "Kur një sëmundje prek vendet e pazhvilluara nuk është një emergjencë. Ai shndërrohet në të tillë vetëm kur preken vendet e zhvilluara", deklaroi profesor Emmanuel Nakoune, drejtor i Institutit "Pasteur" në Bangui, në Republikën Qendrore Afrikane, i cili po zhvillon teste mbi mjekimin e lisë së majmunëve. Megjithatë, Nakoune tha se, nëse OBSH-ja do të shpallë gjendje emergjence, ky do të ishte një hap i rëndësishëm. Komiteti i emergjencave globale mbledhet të enjten për të diskutuar në Gjenevë mbi hapat që do të ndërmerren për ta kufizuar përhapjen e mëtejshme të kësaj sëmundjeje. Në panel

bëjnë pjesë ekspertë nga rajonet më të prekura, të cilët janë konsultuar edhe me shkencëtarë, përfshirë Nakoune. Ata do t'i dërgojnë një rekomandim drejtorit të përgjithshëm të OBSH-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus, i cili merr vendimin përfundimtar nëse do ta shpallë gjendjen e emergjencës. Vendimi, nëse merret, shpall alarmin dhe mund të nxisë hapa të mëtejshëm nga OBSH-ja, sikurse dhe vëmendje të shtuar nga shtetet anëtare. OBSH-ja ka dhënë tashmë udhëzime të detajuara për sëmundjen dhe ka treguar se po punon për një mekanizëm për shpërndarjen e trajtimeve dhe vaksinave. Shumica e ekspertëve pajtohen se lija e majmunëve i plotëson teknikisht kriteret për përkufizimin nga OBSH-ja si "emergjencë botërore". Është një ngjarje e papritur dhe e pazakontë që po përhapet ndërkombëtarisht dhe kërkon bashkëpunim mes vendeve.

Macron: Partitë janë kundër një qeverie të unitetit kombëtar

PARIS, 23 QERSHOR - Presidenti Emmanuel Macron ka përjashtuar mundësinë e krijimit të një qeverie të unitetit kombëtar për momentin. Kreu i Elizesë arriti në këtë përfundim pas konsultimeve me liderët e partive franceze. Duke iu drejtuar francezëve

për herë të parë që nga zgjedhjet e së dielës, kur partia e tij humbi një shumicë parlamentare, Macron pranoi se kishte pasur ndarje të shtuara pas zgjedhjeve dhe i bëri thirrje klasës politike të mësojë të qeverisë dhe të miratojë ligje ndryshe. Partia e presidentit francez

nuk ka fituar një shumicë absolute në Asamblenë Kombëtare dhe duhet të krijojë koalicion. Sipas rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, centristët e Macronit fituan shumicën e ulëseve, 245 nga gjithsej 577, por një shumicë absolute kërkon të paktën 289.



Komandanti i KFOR-it takon ambasadorin e Ukrainës në Serbi

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Komandanti i KFOR-it në Kosovë, gjeneralmajor Ferenc Kajari, ka pritur të enjten në një takim ambasadorin e Ukrainës në Serbi, Volodymyr Tolkach, në selinë e KFOR-it në Prishtinë.

Gjatë takimit është diskutuar për një sërë çështjesh, përfshirë situatën aktuale të sigurisë në Kosovë dhe përgjatë rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Komandanti hungarez i misionit të KFOR-it ka falënderuar ambasadorin Tolkach për kontributin e

vlefshëm të Ukrainës. “Do të doja ta shprehja mirënjohjen time ndaj kontingjentit të Ukrainës dhe për profesionalizimin që ata kanë treguar dhe kontributin e përditshëm për garantimin e sigurisë dhe lëvizjes së lirë të të gjithë njerëzve në Kosovë që nga viti 1999”.

Gjatë vizitës së tij, ambasadori Tolkach është takuar edhe me përfaqësues të kontingjentit të trupave ukrainase të vendosura në misionin e KFOR-it, përfshirë personelin që shërben në

Grupin e Përbashkët të Mbështetjes Logjistike të KFOR-it, si pjesë e Detashmentit për Lirinë e Lëvizjes.

Në misionin e KFOR-it kanë shërbyer 40 ushtarë ukrainas, por ata presin të kthehen në Ukrainë së shpejti për t'i dalë në ndihmë shtetit të tyre.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka nënshkruar një dekret në muajin mars, duke kërkuar nga të gjithë pjesëtarët profesionistë të ushtrisë, që janë në misione paqeruajtëse në botë, të kthehen në Ukrainë.



Deputetët nuk e mbështetin tërheqjen e mjeteve nga Trusti



Projektligji për Trustin përplas Kurtin dhe Haxhiun

Në seancën e së enjtes, kur diskutohet për Trustin, ka pasur përplasje ndërmjet kryeministrit Albin Kurti dhe iniciuesit të Projektligjit, Bekim Haxhiu. Ky i fundit ka thënë se ka shpresuar për një qasje më pragmatike të pozitës në Kuvend lidhur me këtë çështje, ndërsa ka theksuar se e drejta për nisma ligjore u garantohet me ligj. “Mos u bëj presion deputetëve tu, le të votojnë të lirë me bindjen e tyre”, ka thënë deputeti Haxhiu.

Madje Haxhiu ironizoi duke thënë se nëse Kurti vazhdon të qëndrojë në zyrë, atëherë do të ketë nevojë për fizioterapi, për të cilën tha se do të jetë i gatshëm ta trajtojë. “Nëse vazhdoni të qëndroni në zyrë do të keni nevojë për fizioterapi. Jam i gatshëm pa para t’ju trajtoj sa herë keni nevojë...”, ka thënë Haxhiu.

Pas këtyre deklaratave të Haxhiut, ka replikuar kryeministri Kurti, i cili ka thënë se çështja e financave shtetërore, e të ardhmës në ekonomi, ka dimension të fuqishëm profesional dhe duhet të konsultohen paraprakisht profesionistët e ekonomisë.

“Jam shumë i interesuar të di kë ke konsultuar, se nuk je i fushës. Unë do të vij në seancë edhe me respektin më të madh do t’ju dëgjoj kur e merrni nismën e Projektligjit për masazh. Ama për Projektligjin për trust nuk ka kurrfarë kuptimi kjo punë...”, ka thënë ai.

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Projektligji përmes të cilit do të mundësohet tërheqja deri në 30 për qind e mjeteve nga Fondi Pensional, i njohur si Trusti, nuk ka kaluar në Kuvendin e Kosovës.

57 deputetë kanë votuar kundër, 44 për dhe një ka abstenuar.

Ky projektligj nuk ka marrë votat e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, ndërkohë që është votuar nga deputetët e partive opozitare.

Qeveria e Kosovës është shprehur kundër një tërheqjeje të mjeteve

nga Fondi i Kursimeve Pensionale. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës se “nuk mundën që një problem të së tashmes ta zgjidhin me rrënim të së ardhmës”.

Deputetët e partive opozitare në pushtet kanë arsyetuar projektligjin që mundëson tërheqjen e kursimeve pensionale për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike dhe sociale të qytetarëve nga rritja e madhe e çmimeve.

Ata kanë thënë se tërheqja e kursimeve pensionale është kërkesë e qytetarëve.

Deputetët e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët ishin

kundër tërheqjes së këtyre mjeteve, kanë thënë se është precedent i rrezikshëm dhe shkatërron strukturën pensionale të shtetit.

Fondi Monetar Ndërkombëtar është shprehur kundër një tërheqjeje tjetër të mjeteve nga Trusti.

Ky projektligj ishte dorëzuar më 9 mars në Kuvendin e Kosovës nga Partia Demokratike e Kosovës.

Projektligji parashihte që kontributpaguesit që kanë më pak se 10 mijë euro kursime pensionale të kenë të drejtën e tërheqjes së 30 për qind të mjeteve, ata që kanë deri 20 mijë euro, 25 për qind, nga 20 mijë deri 30 mijë, 20 për qind.

Ish-deputeti i PDK-së viziton Veselin në Hagë

HAGË, 23 QERSHOR (ER) - Ish-deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Sejdi Hoxha, ka vizituar ish-kryetarin e kësaj partie, Kadri Veseli, i cili ndodhet në paraburgim në Hagë. Lajmin e ka bërë me dije Hoxha në llogarinë e vet në “Facebook”. “Fillova të ndihesha më mirë kur në një dhomë të veçantë e me një përqaftim të ngrohtë u

përshëndeta me kryetarin Kadri Veseli. Ai me buzëqeshjen e tij, sharmin e tij dhe motivin e tij të lartë që ka gjithmonë ma krijoi përshtypjen që nuk isha në atë ambient, por sikur isha për vizitë në zyrën e tij në Kuvendin e Kosovës. E pyeta për presidentin, bacën Jakup, Rexhën dhe çlirimtarët e tjerë. Fatmirësisht të gjithë ishin mirë dhe me motive të larta.

Pata dëshirë që t'i takoj të gjithë, por ishte e pamundur për shkak të kohës së shkurtër të vizitave që kishin. Gjatë takimit me kryetarin Veseli u hap dera dhe mendova që përfundoj koha e vizitës, kur me një tortë në dorë, si në zakonet e Drenicës, hyri Hysni Gucati i cili na nderoi shumë. Në dalje takova edhe Pjetër Shalën”, ka shkruar Hoxha.





NË SAMITIN BE - BALLKANI PERËNDIMOR NË BRUKSEL, TEMË DISKUTIMI
EDHE LIBERALIZIMI I VIZAVE PËR KOSOVËN

Deklarata pozitive për liberalizimin e vizave, por asgjë konkrete

Në selinë e Bashkimit Evropian (BE) është mbajtur të enjten Samiti BE - Ballkani Perëndimor. 27 krerë shtetesh dhe qeverish evropiane kanë diskutuar me kolegët e tyre nga rajoni mbi sfidat me të cilat përballen së bashku. Temë diskutimi ishte edhe liberalizimi i vizave për Kosovën, ku shumë liderë janë shprehur në favor të kësaj çështjeje. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pas përfundimit të samitit, ka bërë me dije se këtë herë ka pasur me shumë deklaratë mbështetëse për liberalizimin e vizave sesa më parë

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

BRUKSEL, 23 QERSHOR - Perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor dhe e ardhmja e rajonit në Bashkimin Evropian u përsëritën qartë edhe gjatë Samitit të BE-së me liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Zyrtarët e BE-së konfirmuan se lufta në Ukrainë e ka vënë sërish në plan të parë zgjerimin e BE-së, që nënkupton përparim në negociatat e anëtarësimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, përparim në mosmarrëveshjet dypalëshe dhe rajonale, duke përfshirë normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi dhe përmirësimin e marrëveshjes politike në mes të liderëve të Bosnjës e Hercegovinës.

Pjesë e diskutimit në këtë samit të enjten ishte edhe liberalizimi i vizave për Kosovën.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka mbajtur fjalim në takimim e liderëve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, ku ka theksuar se kontinenti ynë është në një gjendje të jashtëzakonshme pas luftës në Ukrainë. Ajo ka thënë se nuk mund të ketë paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në Evropë pa Ballkanin Perëndimor të integruar në strukturat euroatlantike. "Ukraina është nën rrethim, me vlerat, liritë dhe mënyrën e saj të jetesës nën sulm. Ky është një sulm edhe ndaj nesh. Dhe nëse dikush mendon se paqja dhe stabiliteti i qëndrueshëm në Evropë janë të mundur pa Ballkanin Perëndimor të integruar në strukturat euroatlantike, më duhet t'i them, si dikush që e ka përjetuar anën më të errët të luftës dhe shkatërrimit, se kjo nuk është e mundur. Nuk kam ardhur këtu për deklaratë boshe politike,

por me qëllimet më të mira për të folur për pasojat për të gjithë kontinentin tonë po që se integrimi i Ballkanit Perëndimor do të vonohej më tej", ka thënë Osmani, duke shtuar se, pavarësisht prej përparimit të jashtëzakonshëm, populli i Kosovës dëshiron më shumë mundësi dhe përparim. "Ata dëshirojnë një regjim pa viza, për të parë, ndërë dhe përjetuar Evropën. Kjo, thjesht, ka shkuar shumë larg. Qytetarët e mi ndihen të diskriminuar, pavarësisht se janë populli më proevropian dhe i plotësojnë të gjitha kriteret prej katër vjetësh. Ata mbeten të izoluar në zemër të kontinentit ku jetojnë. Ironia është që ne jemi këtu si anëtarë të barabartë të komunitetit ndërkombëtar, duke diskutuar për agjendën evropiane, por sigurisht që unë ulem mes jush sot këtu si i vetmi person, në këtë tryezë që duhet të marrë një vizë

për të marrë pjesë në këtë samit. Për t'i vënë gjërat në perspektivë, ka liberalizim të vizave për vendet e largëta si Venezuela, por qytetarët e Kosovës që jetojnë në një distancë të shkurtër me makinë, që jetojnë në fqinjësinë tuaj, nuk mund të udhëtojnë lirshëm. Kjo është një padrejtësi e madhe. Kosova ka bërë pjesën e saj, tani është radha juaj", ka thënë Osmani.

Konferenca për shtyp, pas pjesës hyrëse të samitit, ku pritej të flisnin liderët e vendeve të BE-së dhe që ishte planifikuar të mbahej rreth mesditës, u anulua. Mësohet se shumë liderë janë shprehur në favor të liberalizimit të vizave për Kosovën dhe presin që kjo çështje të ngrihet në të ardhmen. Ky takim nuk ishte një mbledhje vendimmarrëse.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pas përfundimit të samitit tha se ka dëgjuar shumë deklaratë pozitive për Kosovën nga liderët e BE-së. "Kemi dëgjuar deklarata mbështetëse për Kosovën, së pari për perspektivën e qartë në BE dhe liberalizimin e vizave. Por, tani na duhet të shkojmë nga fjalët në vepra", ka thënë ajo. Sipas Osmanit, kësaj radhe ka pasur edhe me shumë deklarata mbështetëse për

liberalizimin e vizave sesa më herët. "Duhet të them se këto kanë qenë deklaratat më pozitive që i kemi dëgjuar deri më tani për liberalizimin e vizave. Edhe shtetet që kanë qenë hezituese, shumë prej tyre kanë treguar mbështetje sot", ka deklaruar Osmani.

Në një deklaratë për medie, presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviq, tha se gjatë samitit shumë pjesëmarrës kanë folur për liberalizimin e vizave për Kosovën. "Në plan të parë ishte çështja e fillimit të procesit negociator me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë dhe bashkë me të edhe çështja e sigurimit të liberalizimit të vizave për Kosovën. Përveç kësaj, ata folën për dhënien e statusit kandidat jo vetëm për Ukrainën dhe Moldavinë, por gjatë bisedimeve u fol shumë për marrjen e statusit kandidat për Bosnjën e Hercegovinën. Pra, le të shpresojmë që tonet nga ky takim të jenë mjaft frymëzuese për punën e pasdites së sotme të Këshillit Evropian", ka thënë ai. Me tone të ashpra, gjatë konferencës për medie pas samitit në Bruksel, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është shprehur se ajo që po ndodh me

Nga muaji i ardhshëm pritet të zgjerohet skema për shtesat e fëmijëve të lindur para 2015-s

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka njoftuar se nga muaji i ardhshëm zgjerohet skema për shtesat për fëmijë. Sipas Muratit, këto shtesa do t'i marrin fëmijët e lindur nga viti

2014 e tutje. "Me miratimin e rishikimit të buxhetit sot, na bëhet e mundur që duke filluar nga muaji i ardhshëm, ta fillojmë zgjerimin e skemës për shtesat e fëmijëve. Aktualisht shtesa marrin fëmijët e lindur nga 1 janari 2015 e këtej. Nga

muaji i ardhshëm do të fillojë zgjerimi edhe me gjeneratat e tjera (2014, 2013, 2012 etj.), për të përmbushur kështu në tërësi premtimin se do të ketë shtesa për të gjithë fëmijët deri në moshën 16-vjeçare", ka bërë me dije Murati.



çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën është një çmenduri dhe një turp. "Një tjetër pengmarrje është ajo e Kosovës. Është popullata e vetme në Evropë që nuk mund të lëvizë lirisht. Imagjinojeni. Ata ishin në diktaturën jugosllave dhe mund të lëviznin lirisht. Dhe që kur u liruan, çlirimtarët e tyre nuk i lejojnë të lëvizin lirisht. Kjo është e turpshme. Unë u thashë dhe ndihem i keqardhur që e ndjeva si të nevojshme, që Serbia është në realitet krejtësisht tjetër. Flasin për një vend ku popullariteti i Putinit është 80 për qind dhe opinioni nuk është i prirë të vrapojë drejt Brukselit, por jashtë çdo pritshmërie, edhe simes, se sinqerisht nuk e prisja. Tri herë janë harmonizuar me Bashkimin Evropian dhe Perëndimin kundër Rusisë, duke votuar edhe për përjashtimin e Rusisë nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut. Unë nuk e kuptoj çuarjen e gjërave në kufi në raport me kërkesat për sanksionet. Serbia nuk është në pozicion për të realizuar kaq shumë, kaq shpejt dhe çuarja deri në kufi jep efektin e kundërt! Dhe koston do ta ketë agjenda evropiane e Serbisë dhe popullata e rajonit", ka thënë Rama.



Rama dhe Kovaçevski të zhgënjyer me BE-në

Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovaçevski, si dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, janë shprehur të zhgënjyer me Bashkimin Evropian pas përfundimit të samitit që u mbajt në Bruksel të enjten.

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, ndonëse i kanë përmbushur të gjitha kushtet, nuk i kanë nisur ende negociatat për pranim si kandidatë në BE për shkak të vetos bullgare. Bullgaria e ka bllokuar procesin e integritimeve për Maqedoninë e Veriut për shkak të

kontestit mes dy vendeve për çështjen e gjuhës dhe të kaluarës historike.

Kovaçevski të enjten tha se e ka refuzuar propozimin francez për zgjidhjen e kontestit me Bullgarinë. "Falënderoj presidentin Macron për angazhimin, por që propozimi të jetë i pranueshëm duhet të garantojë disa çështje thelbësore, për gjuhën dhe identitetin maqedonas", ka deklaruar Kovaçevski në një konferencë të përbashkët me Ramën dhe presidentin Serb, Aleksandër

Vuçiç.

Franca, e cila kryeson presidencën e BE-së deri më 1 korrik, ka disa javë që mbështet kërkimin e një zgjidhjeje të mosmarrëveshjes midis dy vendeve.

Propozimi francez përmban disa pika, ndër to: Maqedonia e Veriut duhet të konfirmojë para OKB-së se nuk ka pretendime territoriale ndaj Bullgarisë, se do ta përfshijë pakicën bullgare në Kushtetutë, se do t'i rehabilitojë viktimat nga komunizmi jugosllav, se do t'i harmonizojë tekstet shkollorë në

përputhje me punën e komisioneve të historisë, se do t'i heqë të gjitha tabelat që përhapin gjuhën e urrejtjes ndaj bullgarëve dhe Bullgarisë, ndërsa dy vendet do të dërgojnë qëndrime të njëanshme lidhur me pozicionet e tyre për gjuhën maqedonase.

Në konferencën pas samitit të BE-së me liderët e Ballkanit Perëndimor, Kovaçevski tha se ka shprehur pakënaqësinë me dinamikën e negociatave të pranimit. "Çfarë ka ndodhur tani është një goditje ndaj kredibilitetit

të BE-së", tha ai.

Pakënaqësinë me mospërparimin në rrugën për anëtarësim në BE e shprehu edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. "Më lejoni ta shpreh keqardhjen time për BE-në. Më vjen keq për të. Shpresoj që mund të ndihmojmë", tha ai. Ai shtoi se nuk ka shpresuar në shumë përparim në këtë çështje para ardhjes në samit. "Ne kemi shumë për të bërë. Derisa ne vazhdojmë rrugën tonë evropiane, shpresojmë se në shekullin e ardhshëm do të jemi anëtarë", tha Rama.

Ndahet nga jeta regjisorja e njohur Vjosa Berisha

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Është ndarë nga jeta regjisorja e njohur nga Kosova, Vjosa Berisha, e cila po trajtohej në Angli pas diagnostikimit me kancer. Lajmi është dhënë të enjten nga bashkëshorti i saj Fatos Berisha i cili shkruan se Vjosa, e cila po merrte mjekim në spitalin 'University College Hospital' në Londër, ndërroi

jetë pas një beteje të gjatë me kancerin.

Vjosa Berisha ishte themeluese e festivalit "PriFilmFest", edicioni i 14-t i të cilit është planifikuar për 26-30 korrik, ndërsa për t'i mbështetur filmbërësit e Ukrainës, ky edicion do të jetë nikoqir i edicionit të 13 të Odesas. E diplomuar për

master të Arteve në Media dhe Komunikim nga Universiteti i Westminsterit, Londër, në Mbretërinë e Bashkuar dhe me një diplomë pasuniversitare në Diplomaci Bashkëkohore nga Universiteti i Maltës, në Maltë, Vjosa Berisha ka pasur përvojë mbi 20 vjet në industrinë e filmit.



Vizitë familjeve të çlirimtarëve!

Prishtinë, Burojë, Glllogjan, Negrofc e Marinë



Unë (Nusret Pllana) dhe bashkëlufëtari im, Ing. Xhavit Muqolli nga Pokleku i Drenicës legjendare (përfaqësuesi i njëjës prej familjeve më të martirizuara në Kosovë), znj. Zahrie Podrimçaku - Subashi (ish-e burgosur dhe veprimtare e devotshme e çështjes kombëtare, kontribuuesi i palodhur i çështjes kombëtare, z. Ahmet Bytyqi, me bashkëshorten Lumnijën, të cilët me dekada punojnë dhe jetojnë në Danimarkë, Zelfia Pllana dhe Zoja Muqolli, brenda dhjetë ditësh i vizituam familjet e krerëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (atë të presidentit Hashim Thaçi, kryeparlamentarit Kadri Veseli, prof. dr. Jakup Krasniqi, gjeneral Rexhep Selimi, gjeneral Nasim Haradinaj, komandant Sali Mustafa - Cali e atë të luftëtarit emblemantik dhe invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Hysni Gucati, të cilët padrejtësisht po mbahen në burgun famëkeq të Gjykatës së Dhomave Speciale në Hagë, nga kjo Gjykatë njëetnike (Gjykatë e turpmit të "drejtësisë ndërkombëtare"), e cila i akuzon për krime të supozuara, ndërkaq kriminelët e Serbisë pushtuese e gjenocidiale, për të gjitha ato

barbari e mizori mbi shqiptarët civilë duarthatë, të dëshmuara e të faktografuara edhe nga faktori vendor dhe ai ndërkombëtar, i ka falur dhe i ka rehabilituar pa fije turpi!!

Kjo është ajo Evropa "demokratike" e cila shqiptarët gjithmonë i ka trajtuar shekuj me radhë dhe vazhdon t'i trajtojë qytetarë të rendit të dytë edhe sot e kësaj dite!!

Në besojmë thellë në pafajësinë e bashkëlufëtarëve tanë, sepse ata e kanë sakrifikuar jetën për ta mbrojtur popullin tonë të shumëvujtur e liridashës nga gjenocidi serb, ata ishin aleat të përbetuar të NATO-s e të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe, prandaj kërkojmë lirinë e tyre të shpejtë dhe pa kusht, e në vendin e tyre të ulet e të marrë dënimin e merituar sajuesi dhe trilluesi i kësaj aktakuze absurde, Dick Marty - argati i përbetuar i Serbisë dhe Rusisë barbare, i cili, kur e pa që u zhvesh i tëri nga ato trillime ogurzeza për t'i akuzuar çlirimtarët tanë për krime të supozuara, që me çdo kusht të barazohet viktimat me kriminelin (sepse për këtë shërbim të ndytë i kishte marrë milionat nga Beogradi dhe nuk i doli matematika siç kishte

planifikuar) atëherë filloi të 'aktroj' e ta luaj rolin e viktimës, duke kërkuar mbrojtje shtetërore nga Zvicra, se gjoja serbët duan ta vrasin, për t'ua lënë fajin shqiptarëve!!

Familjarët e shokëve tanë çlirimtarë, i falënderojmë nga zemra për respektin, mikpritjen e bujarinë shqiptare që na e bënë këto ditë, me rastin e vizitave tona dedikuara familjeve të tyre, me një moral të lartë e qëndrim dinjitoz e të paluhatsëm, duke shprehur e besuar se më në fund drejtësia do të fiton, e djemtë e tyre, bashkëshortët e tyre, vëllezërit e tyre, nëse vetëm një minimum i drejtësisë ndërkombëtare ekziston në këtë nën qiell, ata duhet të gjithë të lirohen të pafajshëm, edhe pse çdo drejtësi e vonuar është padrejtësi!!

Ps. I kërkojmë falje luftëtarit të lirisë, Pjetër Shala, i cili gjithashtu ndodhet në Hagë për akuza të tilla absurde, se familjen e tij, për shkak të faktit që ndodhet në Belgjikë, nuk mundëm ta vizitojmë, por edhe Pjetrit i dëshirojmë shëndet e lirim të shpejtë nga ai burg famëkeq, i cili po vazhdon t'i terrorizojë shokët tanë çlirimtarë, mu sikur në kohën e fashizmit hitlerian.



Naser Pajazitaj dënohet me burgim të përjetshëm për vrasjen e Donjetës

FERIZAJ, 23 QERSHOR - Gjykata Themelore në Ferizaj në rigjykim e ka dënuar me dënim të përjetshëm Naser Pajazitajn, i akuzuar për vrasjen e Donjeta Pajazitajt në nëntor të 2015-s. Aktgjykimi ndaj Pajazitajt u shpall të enjten nga kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Ibrahim Idrizi, raporton "Betimi për drejtësi".

Ky rast kishte marrë epilog dy herë në Gjykatën Themelore në Pejë ku, pas gjykimit të parë, Pajazitaj ishte shpallur i pafajshëm, kurse pas gjykimit të dytë ai ishte dënuar me burgim të përjetshëm. Por, në të dyja rastet aktgjykimet ishin anuluar nga Gjykata e Apelit, përkatësisht Gjykata Supreme dhe lënda ishte kthyer në rigjykim.

Ndërsa më 27 maj 2021, Gjykata Themelore në Ferizaj e kishte dënuar Pajazitajn me burgim të përjetshëm për vrasje të rëndë, kurse Gjykata e Apelit më 29 tetor 2021 këtë çështje e ktheu në rivendosje në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Fillimisht, Gjykata Themelore në Pejë, në mars të vitit 2018, të akuzuarin Naser Pajazitaj, në mungesë të provave, e kishte liruar nga akuzat për vrasjen e Donjeta Pajazitaj por, pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit e kishte kthyer këtë lëndë në rigjykim.

Pas kthimit në rigjykim, Gjykata Themelore në Pejë, në mars të vitit 2019, e kishte shpallur fajtor të akuzuarin dhe e kishte dënuar me



burgim të përjetshëm. Ky dënim ishte vërtetuar pastaj edhe nga Gjykata e Apelit në korrik të vitit 2019. Por, në nëntor të vitit 2019, Gjykata Supreme i kishte prishur të dyja aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Pejë dhe të Gjykatës së Apelit dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim.

Pas kthimit të rastit në rigjykim, Gjykata Themelore në Pejë ishte përjashtuar nga ky rast dhe lënda ishte deleguar në Gjykatën Themelore në Ferizaj me arsyetimin për t'i mënjeluar dyshimet ndaj sistemit të

drejtësisë.

Vendimi për delegimin e lëndës në Ferizaj ishte marrë nga Gjykata e Apelit.

Gjykata Themelore në Ferizaj, më 27 maj 2021, e kishte dënuar Pajazitajn me burgim të përjetshëm për vrasje të rëndë. Më pas, Gjykata e Apelit e ka kthyer çështjen në rigjykim.

Sipas aktakuzës së ngritur më 8 qershor 2017 nga prokurorja Valbona Disha-Haxhosaj, Naser Pajazitaj akuzohej se më 9 nëntor 2015, në bjeshkët e Strelcit, Komuna Deçan, në vendin e quajtur te "Kroni i

Lajthisë", i pandehuri, edhe pse më parë ka qenë i dënuar për vrasje, me dashje dhe me armë, revole të tipit të panjohur, në mënyrë mizore e ka privuar nga jeta viktimën Donjeta Pajazitaj nga po i njëjti fshat.

Një gjë të tillë, sipas aktakuzës, Pajazitaj e ka bërë në atë mënyrë që, derisa viktimë ditën kritike ka qenë duke shkuar në punë në këmbë së bashku me axhën e saj, kur kanë arritur te bunari i fshatit janë ndarë, ashtu që viktimë ka vazhduar rrugën në drejtim të Strelcit të Epërm dhe kur afrohet për afërsisht 150

metra afër shtëpisë së Nedi Jusaj, atypari kalon i pandehuri Naser Pajazitaj me veturën e tij të tipit Xhip Sherokë me ngjyrë të kaltër, i cili ndalet, e merr viktimën me veturë, më pas vazhdon në drejtim të bjeshkëve të Strelcit dhe kur arrin te "Kroni i Lajthisë" fillimisht e privon me armë duke shtënë dy herë në kokë, më pas, për të humbur gjurmë, e mbulon me disa drunj dhe largohet nga vendi i ngjarjes, kurse viktimë më 27 dhjetor 2015 është gjetur pa shenja jete në vendin e ngjarjes nga disa kalimtarë të rastit.

29 raste të reja me Covid



PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 280 testeve, 29 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të enjten janë shënuar edhe 15 qytetarë, ndërsa numri i

përgjithshëm i të shënuarve është 225 31. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 168.

Ministria e Shëndetësisë në 24 orët ka njoftuar se ka dhënë 37 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë

dhënë 1 830 280 doza të vaksinës.

Deri më sot 823 629 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Po ashtu, deri më sot janë dhënë 103 098 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

Rezultati në Testin e Arritshmërisë, 50.75 për qind

PRISHTINË, 23 QERSHOR (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI) ka publikuar të enjten rezultatet e Testit të Arritshmërisë për klasat e nënta, sipas të cilave, arritshmëria mesatare është 50.75 për qind. Në pjesën e parë të testit

arritshmëria e shprehur në përqindje në lëndët e përfshira në këtë pjesë është 54.4, ndërsa e ndarë sipas lëndëve është: Gjuhë shqipe 57.5 për qind, Gjuhë angleze 74.1 për qind, Histori 42.1 për qind, Gjeografi 50.5 për qind. Në pjesën e dytë të testit, arritshmëria është 47.1 për

qind dhe e ndarë sipas lëndëve është: Matematikë 46.8 për qind, Informatikë 52.1 për qind, Fizikë 45 për qind, Kimi 41.3 për qind dhe Biologji 51.2 për qind. Testit të Arritshmërisë këtë vit i janë nënshtruar rreth 24 mijë nxënës të klasave të nënta.



Sytë kah Serbia për kthimin e borxhit të rrymës



PRISHTINË, 23 QERSHOR - Serbia duhet t'ua kthejë qytetarëve të Kosovës mjetet e ndara për pagesën e rrymës në veri, thotë Emin Sallahu, banor në Prishtinë. "Kthimi i tyre duhet të obligohet nga shteti i Serbisë. Kthimi mund të bëhet në bazë të një marrëveshjeje me këste, sepse forma e pagesës ka qenë diskriminuuese", thotë ai. "Të kthehen [paratë] gjithsesi", thotë edhe Sejdi Krapi, ish-punonjës në kompleksin metalurgjik "Ferronikeli". Që nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë, më 1999, qytetarët e veriut janë furnizuar rregullisht me energji elektrike, por nuk e kanë paguar atë. Kjo ka ndodhur për shkak të refuzimit të strukturave të ndryshme të mbështetura nga Beogradi zyrtar, që kanë operuar në atë pjesë, por edhe për shkak të mosbindjes qytetare. Rrjedhimisht, për rrymën e shpenzuar në veri, qytetarët e komunave të tjera të Kosovës

kanë paguar nga xhepi i tyre nga viti 1999 deri më 2017. Gjatë kësaj periudhe faturat e tyre kanë qenë për 3.5 për qind më shtrenjtë. Nga 2017-ta kjo përgjegjësi e pagesës ka kaluar te Qeveria e Kosovës. Më 21 qershor Kosova dhe Serbia janë pajtuar për zbatimin e një marrëveshjeje për energjetikën, të arritur qysh në vitin 2013, që i hap rrugë pagesës së rrymës nga shpenzuesit në veri. Muhamet Mustafa, profesor i shkencave ekonomike në Prishtinë, thotë se çështja e pagesave të faturave në veri nga qytetarët e viseve të tjera ka mbetur e paprecizuar në marrëveshjen e fundit, por "patjetër që duhet të zgjidhet jashtë saj". Mustafa konsideron se Serbia është fajtorë për mospagesën e rrymës nga konsumatorët në veri sepse, siç thotë ai, ajo i ka manipuluar qytetarëve në atë pjesë. "Qeveria e Serbisë apo donatorët duhet ta marrin përsipër këtë borxh. Në rast se ka vështirësi, duhet të gjenden

forma që ky borxh të mbulohet edhe nga institucionet ndërkombëtare", thotë Mustafa për "Radion Evropa e Lirë". Fatura e përgjithshme e konsumatorëve në veri ka shkuar deri në 12 milionë euro në vit. Fadil Ismaili, ish-ministër i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, nuk beson se do të bëhet kompensimi i mjeteve as nga shteti i Serbisë, as nga institucionet e Kosovës. "Në qoftë se kërkohet nga Serbia, pranohet se kjo pjesë [veriu i Kosovës] është Serbi. Serbia nuk kthen borxhe për konsumatorët e shtetit tënd", thotë Ismaili. Me gjithë insistimin e "Radios Evropa e Lirë", Zyra për Informim e Qeverisë së Kosovës nuk i është përgjigjur pyetjes se si do të rregullohet çështja e kompensimit të këtyre mjeteve. Të njëjtën pyetje REL e ka dërguar edhe te kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, por nuk ka marrë përgjigje.

Si ka ardhur deri te ngarkesa e qytetarëve me faturat e veriut?

Vendimin për pagesën e rrymës në veri nga qytetarët e pjesëve të tjera të Kosovës e ka marrë Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE). Pas ankesave të shumta, Gjykata e Apelit e Kosovës ka vendosur në vitin 2017 që kjo praktikë të pezullohet, duke thënë se është jologjore. Në vitin 2021 Gjykata Themelore në Prishtinë, në bazë të një padie të ushtruar nga institucioni i Avokatit të Popullit, e ka detyruar ZRRE-në që ta obligojë Shërbimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS) për kthimin e mbi 40 milionë eurove te qytetarët e Kosovës, të cilët në periudhën 2012-2017 - kur edhe ka pasur ankese - kanë paguar rrymën e konsumatorëve në veri. Zyrtarë të ZRRE-së kanë thënë për "Radion Evropa e Lirë" se e kanë apeluar në

Gjykatën e Apelit vendimin e Gjykatës Themelore. Kurse KEDS-i nuk ka treguar nëse do të bëhet kompensimi i mjeteve në bazë të vendimit të Gjykatës Themelore. Ismaili thotë se KEDS-i nuk e ka obligim ta kompensojë borxhin për pjesën veriore sepse, sipas tij, kjo kompani "nuk e ka pasur nën kontroll konsumimin" atje.

Kush e ka furnizuar veriun me rrymë?

Nga përfaqësuesit e Kosovës dhe të Serbisë vazhdimisht ka pasur deklarata kundërtëse se kush e furnizon veriun me rrymë. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (KOSTT) ka thënë se furnizimi është bërë nga operatorët e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës por, sipas zyrtarëve serbë, rryma në veri ka arritur nga elektrorritjet i Serbisë. Me marrëveshjen e vitit 2013 për energjinë, parashihet licencimi i kompanisë "Elektrosever", e cila është në pronësi të kompanisë energjetike të Serbisë, EPS (Elektroprivreda Srbije), por në Kosovë është themeluar sipas ligjeve të Kosovës. Kjo kompani do të bëjë edhe furnizimin, edhe faturimin e rrymës së shpenzuar në veri. Besnik Bislimi ka deklaruar më 21 qershor se "Elektroseveri" nuk do të prodhojë rrymë, por do ta blejë atë qoftë nga Korporata Energjetike e Kosovës apo nga një tjetër ofertues në tregun ndërkombëtar, ndërsa inkasimin do ta bëjë vetë. "Elektroseveri", rrjedhimisht, mund të marrë apo blejë rrymë edhe nga kompania serbe EPS. Vendimin për licencimin e "Elektroseverit", ZRRE-ja pritet ta marrë këtë të premte. Në anketat që ka realizuar "Radio Evropa e Lirë" në veri, disa qytetarë serbë kanë thënë se do të paguajnë për rrymën e shpenzuar, disa shqiptarë kanë thënë se do të paguajnë vetëm nëse paratë u shkojnë institucioneve të Kosovës.

Miratohet rishikimi i buxhetit të Kosovës për vitin 2022

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Me 65 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, është miratuar rishikimi i Projektligjit për plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Kosovës për vitin 2022. Me këtë rishikim buxhetit i shtohen edhe mbi 150 milionë euro.

Në hyrje të seancës, kryetari i Komisionit për Transfere, Armend Muja, ka thënë se është miratuar vetëm një amendament. "Komisioni për Buxhet dhe Transfere e ka trajtuar këtë. Është miratuar vetëm një amendament dhe për këtë u është propozuar deputetëve për miratim", ka

thënë Muja. Buxheti për vitin 2022 është 2 miliardë e 748 milionë euro, me një rritje prej 8.7-përqindësh. Të hyrat buxhetore pritet të jenë në vlerë prej 2 miliardë e 364 milionë eurosh apo 15 për qind më shumë në krahasim me vitin paraprak.



INTERVISTË E POETIT XHEVDET BAJRAJ DHËNË GAZETËS "EXLIBRIS" ME 10 MARS 2021

Xhevdet Bajraj: Jetoj në vendlindjen e realizmit magjik dhe i mbart të gjitha plagët e trojeve shqiptare brenda vetes

Intervistoi Andreas DUSHI
(Exlibris.al)

Z. Bajraj, ka mbi njëzet vjet që jeni larguar nga Kosova drejt Meksikës, çka do të thotë se një pjesë e madhe, në mos e gjithë krijimtaria juaj është mburitur larg atdheut. Besoj për këtë fakt, Kosova ndikon digjsh në letërsinë tuaj, apo jo? Ku shfaqet, ku tregohet ky ndikim?

Xh. B: Kurrë nuk e paskam menduar këtë fakt të dhimbshëm; është më se e vërtetë që pjesa më e madhe e krijimtarisë sime ka lindur larg atdheut. Sidoqoftë, atdheun e mbart me vete kahdo që shkoj, si një udhëtar që shpëtoi nga anija e përmbytur të cilin atdheu iu ka kapur për njërin këmbë dhe tash jemi së bashku kudo, bashkë me të gjallët e me të vdekurit. Po ashtu vazhdojnë të vdesin aty njerëzit që i kam njohur dhe i kam dashur, lindin disa që kurrë nuk do t'i njoh. Lulëzohet krimi i organizuar, korrupsioni, hajnia... rrënohet arsimit, shëndetësia, kultura (arti në përgjithësi). Ca vlera etike në të cilat dikur është investuar aq shumë, tani janë zhdukur dhe kjo më dhemb.

Pra, jetoj në vendlindjen e realizmit magjik dhe i mbart të gjitha plagët e trojeve shqiptare brenda vetes, e sidomos ato të Kosovës, dhe veçanërisht ato të Rahovecit. Nga ajo dhimbje lindin poezitë e mia. Nxjerrin kokë si bimët dhe çelin lule të dhembjes me fytyrë njeriu universal.

Ky është një proces dhe jo një vendim. Në të ka edhe dhimbje meksikane a siriane. Ka lexues në gjuhën spanjolle që nuk e kanë idenë se ku gjendet Kosova, por që iu arrin në zemër poezia ime. Kosova dhe letërsia e saj, për mua nuk kanë qenë asnjëherë në një relacion dashurie mes vete, kështu që vetëm Kosovën e mora me vete dhe një pjesë shumë, shumë të vogël nga autorët e viseve tona.

Mbase kjo, dhembja, është karakteristikë e gjeneratës së parë të emigracionit dhe si e tillë është një proces, proces i dhimbshëm, i natyreshëm.

Ndonëse studimet për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi i keni ndjekur në Prishtinë, kur u larguat, ju filluat të shkruani në spanjisht. Si jetojnë këto dy gjuhë brenda jush?

Xh. B: Spanjishtja nuk është gjuha e parë e huaj që e kam njohur, por është gjuha e parë e huaj me të cilën më duhet të komunikoj përditë dhe më është dashur të futem thellë në të, përndryshe si do t'ua mësoja studentëve poezinë, shkrimin e saj, leximin e saj, bashkëjetesën me të?! Edhe pse i kisha ca libra të botuar në Kosovë, që mund të numëroheshin në gishtat e një dore, ata njiheshin edhe për vetë faktin se ishin të shpërblyer. Por jetoja në Rahovec, pra, në provincë, nuk jam njeri që imponohem kështu që "ishim marr vesh" me elitën e shpifur që ata të më injorojnë mua dhe unë ta injoroj

komplet atë.

Pas luftës, z. Fatmir Sulejmani, ish kryeredaktor i revistës dhe i Shtëpisë Botuese *Brezi 9* me seli në Tetovë, Maqedonia e Veriut, përkujdesej për botimin e librave të mi në gjuhën shqipe. Jo vetëm që përkujdesej, por më presiononte, më nxirrte si me zor, insistonte që të shkruaj në gjuhën shqipe dhe kështu kanë lindur ca libra me poezi për të cilët i jam shumë mirënjohës Fatmirit. Njëri prej tyre arriti të futet edhe në planprogramin për vitin e katërt të shkollave të mesme në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut.

Derisa po ndodhte kjo, në Meksikë u botua libri im i dytë "El tamaño del dolor" që u prit jashtëzakonisht bukur nga kritika dhe lexuesi meksikan. Arriti të futet nëpër biblioteka publike dhe po ashtu edhe në bibliotekat universitare në Meksikë dhe në disa universitete në SHBA. Në Kosovë më kishin "harruar" plotësisht. Edhe sot e kësaj dite në katedrën e Letërsisë dhe Gjuhës shqipe të Universitetit të Prishtinës, në lëndën e Letërsisë bashkëkohore shqipe nuk përmendet poezia ime. Kjo më dhimbte shumë, se Kosovën më duhej ta tërhiqja me vete kahdo që lëvizja në Meksikë. Shtu kësaj sfidën e pafuzueshme të përpjekjes që të shkruaj në gjuhën e Borhesit, Kortasarit, Markesit, Pasit, Nerudës, Valjehos, Huidobros, mos t'i rendis tashit gjeneratave spanjolle të 98shit, 1914, 1927, 1936, 1940, 1950 etj. T'i bie shkurt, pushova së shkruari në gjuhën shqipe, paj në Kosovë dhunohej liria e lëre me poezia e Xhevdet Bajrajt. Kjo vazhdoi për 10 vjet, më duhet të them që në Tiranë,

në Globus R, poeti i njohur shqiptar, Petraq Risto e botoi "Shpuplumi i shqiponjës" që ishte një antologji personale, me poezitë e mia nga librat e botuar para luftës dhe nga librat e botuar në Tetovë, të shoqëruara me njëzet apo tridhjetë poezi të përkthyer nga gjuha spanjolle. Po ashtu, me insistimin e dramaturgut Jeton Neziraj, e përktheva një poemë time nga gjuha spanjolle, e shndërrrova në monodramë, "Vrasja e mushkonjës", e cila e fitoi çmimin *Katarina Josipi*, u përktheu në gjuhën serbe, angleze, gjermane dhe turke. Ideja më lindi natyreshëm sepse një regjisor argjentinas e pati adaptuar për teatër, shfaqje e cila u shfaq në Argjentinë dhe në Meksikë. Pra, pushova së shkruari në gjuhën shqipe deri në vitin 2014 apo 2015, derisa e takova në Meksiko Siti publicistin dhe shkrimtarin e njohur, Veton Surroi, një njeri për të cilin kisha dhe vazhdoj të kem shumë respekt. Ia dhurova ca tituj të librave në gjuhën spanjolle dhe u ndjeva keq kur i tregova që këta tituj nuk ekzistonin në gjuhën shqipe. Më kërkoi që ta pregatis një libër dhe t'ia dërgoj për *Botimet Koha*. Pastaj zonja Flaka Surroi u përkujdes për botimin e tij me titull "Copa ime e qiellit" dhe për botimin e librit të radhës "Lëngu i



trëndafilave". Ishte një bashkëpunim i jashtëzakonshëm me *Botimet Koha*. Bashkëpunimi me Koha-n është i rëndësishëm sepse m'u desh që krahas lexuesit meksikan, t'i kushtoja më shumë kujdes edhe lexuesit shqiptar. Pastaj librin e radhës, "Vitet që nuk e sollën pranverën" e botoi Klubi Letrar "De Rada" nga Ferizaj, që po ashtu ishte një bashkëpunim i shkëlqyeshëm me kryesinë e këtij klubi. Tash botoj në Shtëpinë botuese "Armagedoni", me pronarin e saj e kam po ashtu një bashkëpunim që më bën të ndjehem autor i privilegjuar i kësaj shtëpie botuese. Shumica e këtyre librave u botuan në gjuhën shqipe dhe atë spanjolle. Me kalimin e kohës, si të shpjgohem, u zhdruk rëndësia se në cilën gjuhë shkruaj dhe sivjet për herë të parë pas gjashtëmbëdhjetë vjetëve, "Armagedoni" do t'i botojë disa libra të mi të shkruar në gjuhën shqipe, natyrisht, në ta nuk do të mungojë edhe motivi meksikan. E stërzgjata me përgjigje dhe i kërkoj ndjesë lexuesit, por për ta shpjguar se si bashkëjetojnë dy gjuhë brenda një autori është më shumë çështje kulturore, individuale, që ka të bëjë me lidhjet e tyre, secilit veç e veç, me letërsinë.

Për të qëndruar edhe pak këtu, te lidhja me gjuhën: Ka raste kur shkrimtarë të ndryshëm, kujtoj këtu Mira Meksini, pasi shkruajnë në shqip, letërsinë e tyre e përkthejnë në një gjuhë tjetër. Ndërsa me ju ndodh e anasjellta, në fillim shkruani spanjisht e mandej, në shqip. Ky proces, më tepër se përkthim, a është rishkrim i poezisë? Dhe, a ndodh natyreshëm, apo i shtyrë nga kushedi çfaktorë?

Xh. B: Nabokov e Brodski, edhe pse vinin nga një letërsi e madhe, kanë krijuar në gjuhë të huaja. Pol Celan, një nga poetët më të mëdhenj të poezisë universale, ka qenë "i dënuar" që tërë jetën të shkruante në gjuhën e vrasësve të familjes së tij dhe të popullit të tij. Jeta di të bëjë

kësi "shaka". Është e gjatë lista e shkrimtarëve që kanë funksionuar shkëlqyeshëm në gjuhë të huaja. Ajo që di të them është se një krijues mund të shkruajë në gjuhën e tij amtare e pastaj ta përkthejë veten në gjuhë të huaj, por kjo nuk funksionon kështu. Të jem preciz, do të funksionojë, por si libër i përkthyer. Ta ilustrim këtë me një shembull konkret: po t'ia hiqim shënimin që është libër i përkthyer në gjuhën spanjolle romanit "Nëpunësi i pallatit të ëndrrave", jo vetëm që në mënyrë automatike pushon magia e këtij romani, por autorin do ta përceptonin si një të humbur në kohë. Sepse është një rrymë, një propozim estetik tashmë i tejkaluar. Natyrisht që elemente të saj do ta shoqërojnë prozën edhe për një kohë, por të krijosh do të thotë të ecësh përpara, do të thotë lëvizje, do të thotë të pushtosh hapësira, horizonte të reja, do të thotë të jesh i lirë. E kjo e fundit është më e rëndësishmja dhe një krijues i mirëfilltë për asgjë në këtë botë nuk do ta sakrifikoje as një pëllëmbë të lirisë që e ka pushtuar vetë, qoftë edhe nëse në atë copë të lirisë autori shënon "rënie". E futa brenda thojzave këtë sepse edhe rënia do të thotë fluturim. Liria është diçka përtej... Shqipja dhe spanjishtja nuk janë uji e zjarri brenda meje, janë dy zjarre që bashkohen. Janë dy zogj në një distancë të shkurtër mes veti dhe... po ua dhuroj lexuesve tuaj një poezi të pabotuar në gjuhën shqipe, KËNGA E DASHURISË apo PARA SE TË FLUTURONIN ZOGJTË: Fluturimin e ka zbuluar zogju/ kur e ka dëgjuar një zog tjetër/ duke kënduar për dashurinë. Pra duhet të ndodh natyreshëm, e kjo ndodh kur bashkëjetojnë me një popull, me historinë e tij, traditën, muzikën, filmin, letërsinë. Kur ia njeh gëzimin, hidhërimin, plagët. Dhe një këshillë për krijuesit e rinj, gratis: mos gënjeni, mos u përpiqni të mashtronit, as në gjuhën amtare e as në atë të huaj, se mendja mund të manipulohet, por shpirti assesi.

T'ju them të drejtën, pyetja e mëparshme lindi edhe për shkak të një tjetër fakti: Përveçse poet, jeni edhe përkthyes, spanjisht – shqip si dhe anasjelltas, shqip – spanjisht. Mbi çka ndërtohet raporti i përkthimit të një tjetër shkrimtari dhe i përkthimit të vetes?

Xh. B: Kur përkthej, përpiqem t'i përmbahem originalit dhe të përpiqem ta bart në gjuhën tjetër sa më natyreshëm, e që të ndodhë kjo, nuk mjafton ta njohësh vetëm gjuhën, por duhet të ngrihesh në majë të gishtërinjve dhe të shohësh në shpirtin e një populli të tërë. Ta zëmë, Huan Rulfo është një shkrimtar brilant. Mirëpo, një argjentinas apo një spanjoll, edhe pse gjuhën spanjolle e ka gjuhë amtare, kurrë nuk do ta kuptojë atë pa e kuptuar Meksikën, popullin meksikan dhe pa e kuptuar regjionin prej nga vjen Huan Rulfo. Kur e përkthej veten e kam shumë më lehtë, sepse e njoh popullin shqiptar dhe atë meksikan po ashtu. Unë jam pikë takimi i dy kulturave/gjuhëve dhe mbahem për atë pikë me thonjtë e zemrës. Thjesht, jam përkrahës i idesë që gjuha na humanizon. Kuptimi që bartin fjalët, mesazhi, emocioni na humanizon dhe jo loja kot e fjalëve, jo gëzhoja e tyre. Kjo e fundit në poezi prodhon vetëm zhurmë të maskuar.

Para se të flasim pak më konkretisht për poezinë tuaj, tanimë si shkrimtar, ndjej t'ju pyes nëse letërsia shqipe njihet ndopak në Meksikë e nëse po, çvend zë tablonë e përgjithshme letrare të atij vendi?

Xh. B: Për fat të keq, letërsia shqipe nuk njihet në Meksikë, trevat tona janë të rrethuara nga italianët, grekët dhe sllavët e jugut. Unë gjithandëjua dhuroj miqve të mi romanet e Kadaresë dhe të Kongolit dhe u flas studentëve për autorët që caktuar. E kam botuar në spanjisht edhe "Antologjinë e poezisë bashkëkohore shqiptare" të cilën ua dhuroj me shumë qejf studentëve të mi dhe e cila më shërben t'ua shpjgoj edhe rrethanat në të cilat është krijuar ajo. Por po ashtu, në orët e tjera gjatë semestrit u flas edhe për poezinë e popujve të tjerë. Shumë pak bëjnë shtetet tona për shpërndarjen e vlerave tona letrare. Them shumë pak, se mbase Ministrinë për kulturë edhe i dedikojnë ca lekë për këtë punë, por ato përfundojnë në duart e sharlatanëve që tërë ditën qëndrojnë nën dritaret e asaj ministrie dhe krockasin për ata lekë sikur janë duke vdekur urie. E krockamat nuk mund t'ia shesësh botës, aq më keq, nuk i pranojnë ato qoftë edhe si dhurata.

"Jeta e poetit/ një pikë ujë/ që refuzon të derdhet në det/ avullohet/ dhe kthehet në tokë/ për ta ushqyer një bimë/ a për t'ia shuar etjen një futuri/ që sapo braktisi rrobat e krimbit/ mbi varrin e ri..." —

nga ku është marrë kjo pjesë titullohet "Pika e ujit". E nëse jeta e poetit është një pikë uji, po uji si plotni, pra si e tërë, është poezia? Në ç'mënyrë kjo "pikë" i përshtatet "së tërës"?

Xh. B: Është një pikë e ujit që përmban në vete të gjitha karakteristikat e pikave të tjera apo ujin si plotni. Ama kjo refuzon të derdhet në det, lexo të vdesë, kështu që rebelohet, shndërrohet në shi, pikë shiu dhe kthehet në tokë për ta ushqyer një bimë... e shoqëron njeriun edhe përtej vdekjes.

T'ia përkujtoj ndokujt që ka nevojë për shpjegim, nuk po flasim për ndonjë religjion të caktuar, por për poezi në të cilën edhe pse po flasim për një pikë uji, njeriu është në qendër të saj.

Në poezinë tuaj gjejmë të pranishëm edhe motivin e lirisë. Ama, ngjan sikur atë nuk e kërkon në vetvete, por synoni ta shpjegoni për të pasqyruar mungesën e saj. "E për ata që ende nuk e kuptojnë liri do të thotë kur krimbat shndërrohen në flutur/majmuni në burrë të ril e burri të bëhet njeri". Xhevdet, këto metamorfoza që ndodhin në liri, kur keni ndërjet të shfaqen për herë të parë në poezinë e Kosovës?

Xh. B: Eh, liria në Kosovë, apo në Ballkan në përgjithësi duket si një nocion abstrakt, kur e kemi parasysh që brenda një shtëpie, apartamenti apo kasolleje jetojnë dy gjenerata, breza, të mos them më shumë. E tash krahasojeni me kuptimin e lirisë së Nikos Kazancakisit që të ngjeth mishtë. Shiko, njeriu normal medoemos duhet të jetë i lirë, e të qenit gjallë, paj, të qenit gjallë sa për të qenë gjallë, mund ta shpie njeriun në një stad më të ulët se të çdo shtaze apo insekti të lirë. Në qendër të civilizimit oksidental qëndron individi, jo pa arsye, sepse kur dikush përpiket ta gjunjëzojë, apo ta dhunojë një popull, do ta ketë shumë më vështirë ta bëjë këtë me secilin veç e veç. Nejsë, ne si popull nuk e kemi këtë problem, ne me vite votojmë dhunuesit e lirisë sonë vullnetarisht. Kur jemi te liria e individit, disa e gjejnë lirinë në alkool, në drogë, disa në art, e disa në të gjitha këto së bashku. Ajo liri nuk gjendet në nivelin e artit mesatar, por në kufinj të një propozimi estetik që mbretëron brenda epokës në të cilën jeton krijuesi. E po ai krijues, duhet ta përshkojë mospërmasë atë bërthamë, e jo të ndalet aty.

Kam frikë se poezia e Kosovës është në krizë të thellë dhe jo vetëm poezia, por edhe gjinitë e tjera letrare. Ajo që mbahet për këmbën time ka vetëm ca emra të përveçëm krijuesish, të tjerët, shumica e tyre, për fat të keq, me apo pa vetëdije, i thurin lavde injorancës. Nëse do të kishin kontakt me poezinë e indianëve të Amerikës Latine, do të duheshin të turpëroheshin. I përmenda banorët e vjetër të Amerikës dhe poezinë e tyre qoftë edhe këtë aktuale, që na përkujtojnë zgjuarsinë e të parëve tonë, fëmijërinë e njerëzimit dhe mënyrën e tyre të pafajshme për ta parë, për ta shijuar botën dhe për t'i emëruar gjërat që i kanë rrethuar. Poeti duhet të ketë trashëguar diçka nga ai sinqeritet. Por të paturpët nuk e njohin këtë ndjenjë, prandaj edhe qëndrojnë poshtë dritareve të Ministrisë për Kulturë apo



institucioneve ndërkombëtare dhe presin t'u bie ca "ushqim" nga ato dritare. Kjo ta lë përshtypjen e gabuar që shteti vepron kundër artit. E kjo është një e vërtetë e mangët. Por kjo është temë tjetër, ndërsa unë po ngutem t'iu përgjigjem pyetjeve tuaja në momentin e fundit.

Po poezia juaj në përgjithësi, pa u ndalur në raste të veçanta, në ndërlihdjen e krijuar me lirinë, a është manifest i saj, kërkim i pareshtur drejt zbulimit të saj apo gjësend tjetër?

Xh. B: Natyrisht, jetën, lirinë, njeriu mendon që i njeh, që i di ato, por në të vërtetë shumë pak, apo të mos them asgjë nuk di për to. Edhe kur njëra sakrifkohet për tjetrën, jeta për lirinë apo liria për jetën, sërish kam frikë që nuk di për to (respekt të rënëve në të gjitha luftrat për ta mbrojtur atë që e njohim si liri). Arti e plotëson këtë, e krijon këtë lidhje, qoftë bile duke i përshkruar të dy anët e rrugës që shpie në var, prandaj dita e lindjes deri në ditën e vdekjes. Shtu kësaj barrën e ëmbël të dashurisë, apo atë të hidhurën, mungesën e saj (dashurisë). Kazancakis edhe dashurinë e merr si pengesë për ta arritur lirinë, prandaj edhe thashë që liria e tij të ngjeth mishtë. Sidoqoftë, liria krijuese, poezia, është si uji i dëgjueshëm, i disiplinuar që i lidh dy brigje, dy a më shumë ishuj, dy a më shumë zemra, mes veti. Nëse në poezi nuk ndodh kjo, atëherë ajo thjesht do të ishte e barabartë me një masturbim estetik.

"Kam kohë që jam i vdekur! Por kam përshtypjen se jam duke i ëndërruar këto që i shkruaj". Nëse vërtetë po ëndërrohen këto që shkruani, kur të zgjoheni, si do ta kujtoni këtë ëndërr?

Xh. B: Nganjëherë duhet të vdesim që të mund të këndojmë (të shkruajmë poezi për jetën), ndonjëherë, apo shumë shpesh, e bëjmë këtë duke vdekur, figurativisht po shprehem, dhe nuk po flas për autorët që ka kohë që kanë vdekur e ne i lexojmë me ëndje, apo një numër të konsiderueshëm të tyre, i refuzojmë me ëndje. Po ashtu, nganjëherë më duket se i ngjaj një heroi të njërës nga poezitë e mia, që ngrihet nga varri dhe shkon në kërkim të një atdheu tjetër për të vdekur për të, e ku nuk do të abuzohej me lirinë, kështu që këndon brenda një varri dhe mbase ka kush e dëgjon këngën e një të vdekuri.

A. D: "Muza më çmend! Thotë se/ poeti nuk mund të fle/ pa e zbutur tokën e egër/ pa u kthyer në atdhe". Kjo poezi, vërtetë më ka tronditur! Por njëkohësisht, më ka bërë të mendoj: poeti e mbart apo e krijon atdheun? Ju, si mendoni?

Xh. B: E krijon dhe e mbart. Herë unë e ngreh zhagas, herë ai më shtyn përpara. Edhe po të kthehesha në Kosovë, kjo nuk do të ndryshonte, sepse një lloj atdheu tash e kam Meksikën. Para se ta ndjeja Meksikën kështu, mendoja që jam si një pemë që e kanë sjellë në një pjesë të botës me kushte shumë të volitshme, por që ajo pemë është krijuar për Kosovë dhe që nuk mund të çelë lule apo të jep fruta larg Kosovës. Pas tërë këtyre viteve në Meksikë, mbase edhe po të kthehesha në Kosovë a Shqipëri, do të më ndiqte e njëjta ndjenjë, se më është kapur diçka për njëherë këmbë. Si duket për momentin, qenkam lindur që të këndoj shumë larg Kosovës.

Një tjetër motiv, mjaft i rëndësishëm, veçanërisht në *Copa ime e qiellit*, është edhe gruaja. Në një poezi me këtë titull, pra *Gruaja*, shkruani "Sa e dhimbshme do të ishte të jetohej një jetë e tërë dhe një herë të paktën një herë të mos i përkushtohet një poezi/ një gruaje". Edhe unë ndaj të njëjtin mendim, por për arsye që vështirë t'i kuptoj, ndaj vargje të tilla më ngjan sikur po më lexojnë, jo sikur po i lexoj. Prandaj, dua t'ju pyes ju, thjeshtë, pse? Pse do të ishte kaq e dhimbshme?

Xh. B: Sepse gruaja bën që të të çelë lulja e ballit, të të lëvizë kapaku i kresë, të të skuqen mollëzat e faqeve, të të këndojë zogu brenda kafazit të kraharorit, të të fluturojnë zogjtë e këmbëve ose të të dridhen lidhëset e këpucëve. Kjo është veç një pjesë e gjërave që do të mund t'i ndodhnin njeriut. Nejsë, ishte një shaka me një gjysmë poezie. Kështu e kam më lehtë të përgjigjem, se të them për shembull që një njeri që kurrë nuk ka qenë i nxitur nga një grua për ta shkruar një poezi, nuk është një njeri komplet. (Respekt për homoseksualët!).

Ju keni shkruar poezi për nënën, babain, vëllain, nipin... Në ç'mënyrë ndërthehet në një krijim marrëdhënie e krijuesit me njerëzit e tjerë, qofshin ata familjarë, miq, të njohur a të panjohur?

Xh. B: Këto poezi janë më shumë klithje, klithjet e fundit të individit

brenda methanave në të cilat jeton. Thirrje për t'u zgjuar nga gjumi. Shfaqen në to problemet sociale me të cilat ballafaqohet Kosova, përcillen mesazhe politike, e në të vërtetë kudo është një dashuri e madhe për njeriun, për të afërmin. Është një nga mënyrat për të komunikuar me lexuesin shqiptar, sidoqoftë, edhe në gjuhën spanjolle u arrijnë njerëzve në zemër.

Poezitë e librit tuaj "Kafe me nënën" paraqesin ndjenjën e një dhimbjeje të sinqertë për të pashmangshmen: vdekjen. Mes të tjerash, aty keni një poezi me titull "Të vdekurit nuk janë larg". Si mendoni, çfarë na ndan nga të vdekurit?

Xh. B: Ne nga ata na ndan një frymëmarrje, një e rrahur zemre a qerpiku. Në të vërtetë ata jetojnë me ne, na detyrojnë të bëhemi më të mirë, më të këqinj, na i mbajnë të hapura dyert e jetës e të lirisë, nganjëherë nuk na lënë të flemë. Na detyrojnë apo na ndihmojnë të dashurojmë. Na mësojnë të gjitha, por zakonisht nuk kemi veshë t'i dëgjojmë. Ashtu si nuk kemi veshë t'i dëgjojmë kafshët e egra dhe të buta, yjet, muzikën e tyre, fijet e barit... E ato, dua të besoj se na dëgjojnë.

Po poezia, a e zgjeron apo e ngushton këtë largësi?

Xh. B: Brenda saj (poezisë) koha rrjedh ndryshe dhe nuk matet dot as me orë alafanga as me atë allaturke. Prandaj në poezi asgjë nuk na ndan nga ata, përkundrazi, ajo na lidh më shumë. Poezia e ngushton aq shumë largësinë, sa që nganjëherë është vështirë të dallojmë se kush është gjallë e kush i vdekur. Poezia është një dritare drejt së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes. Të shkruash do të thotë të shpjegosh vetveten. Të jesh i vetëdijshëm se gjërat që i sheh, qoftë si i verbëri që i sheh me prekje të dorës, të shohin edhe ato ty.

Në titujt e librave të tu, lexojmë se përveç nënës, keni edhe Rahovecin (Ca kokrra rrushi të Rahovecit). Është interesante, pasi vetëm në këto raste, vërehet qartë një konceptim konkret i titullit. Ndaj, vetvetiu më lind pyetja: Në jetën tuaj letrare, nëna dhe vendlindja ç'rol kanë? A ekziston një lidhje gati transhendente mes tyre?

Xh. B: Pajtohem, bile kështu është për mua. Njerëzit dhe vendet lidhen fuqishëm në mua, apo më mirë ta

them ndryshe, unë lidhem me njerëz dhe me vende fuqishëm, pothuaj në mënyrë të pandashme. Dhe kur ndodh të na ndajnë e ndje se si më hiqet një copë mishi, pa anestezi. Kur shkoj në Rahovec, pjesën më të madhe të kohës e kaloj me shokët e fëmijërisë. Është një ndjenjë e papërshkrueshme. Sapo të ulët aeroplani në aeroportin e Rinasit apo në Prishtinë, unë shndërrohem në fëmijë, pas një muaji, po në të njëjtët aeroporte, unë ndjehem plak me disa qindra vjet jetë.

Mund të jem i lumtur në Sarandë, Kavajë, Kukës a Tetovë, janë njerëzit, rruga, qyteti që ma japin këtë ndjesi dhe pse jo, edhe kafenetë e qytetit. Nuk mund të jem i lumtur në Shqipëri vetëm në vitin 1997.

Xhevdet, përveç poezisë, ju jeni gjithashtu protagonist në filmin "Aro Tolbukhin – Në mendjen e vrasësit" (Aro Tolbukhin – En la mente del asesino), të regjisorit spanjoll Agustín Villaronga, film ky që ka qenë fitues i disa çmimeve ndërkombëtare. Çfarë ju motivoi për t'u marrë edhe me një tjetër formë të artit, përveç letërsisë?

Xh. B: E dua filmin; erdhi regjisori dhe më ftoi të jem pjesë e projektit. U habita shumë, por e kisha kureshtjen e fëmijës, thashë ta provoj edhe këtë. Ishte një përvojë fantastike me ekipin e filmit, sidomos më pëlqente ajo që ndodhte prapa skenës. Kur e shikova filmin për herë të parë, e vërejtja se çfarë do të thotë të punosh brenda një ekipi. "Poeti" në këtë rast ishte regjisori, në të vërtetë kishte goxha poetë aty e unë nuk isha as Robert de Niro e as Al Paçino.

Ndërkohë, ju jeni profesor në "Akademinë e Krijimitarisë Letrare" në "Universidad Autónoma de la Ciudad de México". Në Shqipëri, por besoj se edhe në Kosovë, një Akademi e tillë mungon. Ç'mësim, nga formimi pedagogjik, por edhe ai letrar, mendoni se mund të ndani me krijuesit që e lexuan këtë bisedë?

Xh. B: Studentëve iu flas për atë se e kanë një rast të mirë të mos e kalojnë jetën në gjumë, se gjatë rrugës së jetës mund të mbështeten në poezinë dhe se ajo viza në mes të datës së lindjes dhe të vdekjes mbi gurin e varrit të tyre do të paraqesë një aventurë të jashtëzakonshme për vizitorët e varrezës apo të bibliotekës. Se e kanë një rast të mirë t'u flasin stërnipave me shpirtin e një epoke, për autorin personalisht dhe për njerëzimin. U them ta gjejnë një shpirt binjak në një kohë tjetër, në një kontinent tjetër. Se poezia është përgjigjja më e pastër e qenies njerëzore në pyetjet thelbësore në lidhje me jetën, dashurinë dhe vdekjen. Pastaj ua lexoj disa poezi, si për shembull *Arti poetik* të H. L. Borhesit, *Arti poetik* të V. Huidobros, *Një këngë për fundin e botës* të Ç. Milloshit apo *Itakën* e K. Kavafis apo këtë:

Ç'është poezia? – thua ndërsa e ngulit në bebëzën time të syrit bebëzen e kaltër tënde.


Ç'është poezia! Dhe ti më bën këtë pyetje?

Poezia... je ti.

Gustavo Adolfo Beker (Gustavo Adolfo Bécquer)

Faleminderit, për zemërsisht!

Xh. B: Faleminderit juve, ishte një kënaqësi për mua.



EURO GLASS
SAINT-DONAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kosova përmirëson pozitën në renditjen e FIFA-s, Shqipëria nuk ndryshon pozicion

PRISHTINË, 23 QERSHOR - FIFA e ka publikuar renditjen e re të kombëtareve. Kosova ka shënuar përmirësim në krahasim me renditjen e kaluar. "Dardanët" tani renditen në pozitën e 106, me 1183.9 pikë, duke e përmirësuar pozitën për një vend. Përmirësimi i pozitës në renditjen e FIFA-s vjen pas katër ndeshjeve të zhvilluara gjatë këtij muaji, ku Kombëtarja e Kosovës realizoi

dy fitore (kundër Qipros dhe Irlandës së Veriut) dhe dy humbje (kundër Greqisë) në kuadër të edicionit të ri të Ligës së Kombeve. Pozita e 106 njëherësh është më e mira për Kosovën që nga anëtarësimi në këtë institucion në vitin 2016. "Dardanët" do të rikthehen në skenë në muajin shtator, kur do t'i luajnë dy ndeshjet e fundit të këtij edicioni të Ligës C në Ligën e Kombeve kundër Qipros në

"Fadil Vokrri" dhe kundër Irlandës së Veriut në udhëtim. Ndërsa Shqipëria nuk ka ndryshuar pozicion në renditjen e re të FIFA-s. Kombëtarja shqiptare nuk ka lëvizur nga pozita e 66, duke e mbajtur atë vend pas ndeshjeve të qershorit. "Kuqezinjtë" kanë barazuar me Islandën dhe kanë humbur 2:1 me Izraelin gjatë këtij muaji por, përkundër kësaj, nuk kanë lëvizur nga pozicioni i tyre.



Zgjedhjet për presidentin e ri të UEFA-s, FShF-ja mbështet kandidaturën e Ceferinit



TIRANË, 23 QERSHOR - Federata Shqiptare e Futbollit (FShF) ka vendosur ta mbështesë zyrtarisht kandidaturën e Alexander Ceferinit për pozitën e presidentit të UEFA-s në mandatin e ardhshëm 2023-2027. Ky vendim është marrë në mbledhjen e fundit të Komitetit

Ekzekutiv të UEFA-s, pasi është shqyrtuar propozimi dhe është rënë dakord në mes të anëtarëve për ta mbështetur kandidaturën e presidentit aktual të UEFA-s. Zgjedhjet për kreun e ri të UEFA-s do të zhvillohen vitin e ardhshëm, ndërsa Ceferini do të

garojë për një mandat të tretë. Alexander Ceferin është zgjedhur fillimisht në krye të UEFA-s në shtator të vitit 2016 dhe është rizgjedhur në këtë pozitë në shkurt të vitit 2019. Nën drejtimin e tij, UEFA ka njohur suksese të mëdha në arenën ndërkombëtare përmes

kompeticioneve në nivel kombëtaresh e klubesh, që janë ndër më elitaret në botë, ndërkohë që edhe mbështetja e tij për federatat anëtare, veçanërisht për Federatën Shqiptare të Futbollit, ka qenë e madhe dhe e vazhdueshme në të gjitha drejtimet.

Zidane për të ardhmen: Nuk ka mbaruar përpjekja me kombëtaren e Francës

PARIS, 23 QERSHOR - Prioriteti i Zinedine Zidane është të jetë trajner i kombëtares së Francës dhe jo i Paris Saint Germainit (PSG-së) apo ndonjë klubi tjetër. Ish-trajneri i Real Madridit ka qenë i lidhur shumë me zëvendësimin e Mauricio Pochettino në PSG dhe ai, gjithashtu, ishte i lidhur me punën e Manchester Unitedit para se ta emëronin Erik ten Hag. "Nuk kam mbaruar me

'gjelat'", ka thënë ai për gazetën franceze "L'Equipe", si pjesë e një reportazhi special për ditëlindjen e tij të 50. Presidenti i PSG-së, Nasser Al Khelaifi, së fundmi ka folur për "Marca" për respektin që klubi mban për Zidane. "Për Zidane dua të them diçka të rëndësishme. Ai është një person që më pëlqeu shumë si lojtar dhe më pëlqen si trajner. E dua atë. Por ne nuk kemi folur asnjëherë me të, drejtpërdrejt apo tërthorazi.



Unë e respektoj shumë dhe e vlerësoj shumë. Shumë gjëra kanë dalë në shtyp, por ne kurrë nuk kemi folur me të", ka thënë ai. "Problemi" për Zidane është Didier Deschamps. Fituesi i

Kupës së Botës më 2018 dhe, së fundmi, i Ligës së Kombeve, trajneri aktual i Francës, ka fituar të drejtën të largohet sa herë të dojë, duke përjashtuar një fatkeqësi në Katar. Në krye që nga viti 2012, kapiteni i Francës në Kupën e Botës 1998 mund të mbyllë një cikël me Botërorin e tij të tretë, kompeticionin e tij të pestë të madh me ekipin kombëtar. Ky do të ishte çelësi i ardhjes së Zidane në stol. Nëse pozicioni bëhet vakant, me Zidane e

libër dhe i gatshëm, do të ishte e çuditshme që Federata Franceze e Futbollit të mos e mbushte boshllëkun me një nga legjendat e mëdha të futbollit francez. "Ai është një njeri që e vlerësoj. Ne nuk do ta përcaktojmë karrierën e tij si lojtar apo trajner. Zidane një ditë do të arrijë në kombëtaren franceze. Kur? Nuk e di", pati thënë vitin e kaluar Noel Le Graet, presidenti i Federatës së Futbollit.

PSG-ja është e gatshme ta shesë Neymarin

Paris, 23 qershor - Prioriteti i Zinedine Zidane është të jetë trajner i kombëtares së Francës dhe jo i Paris Saint Germainit (PSG-së) apo ndonjë klubi tjetër. Ish-trajneri i Real Madridit ka qenë i lidhur shumë me zëvendësimin e Mauricio Pochettino në PSG dhe ai, gjithashtu, ishte i lidhur me punën e Manchester Unitedit para se ta emëronin Erik ten Hag. "Nuk kam mbaruar me 'gjelat'",

ka thënë ai për gazetën franceze "L'Equipe", si pjesë e një reportazhi special për ditëlindjen e tij të 50. Presidenti i PSG-së, Nasser Al Khelaifi, së fundmi ka folur për "Marca" për respektin që klubi mban për Zidane. "Për Zidane dua të them diçka të rëndësishme. Ai është një person që më pëlqeu shumë si lojtar dhe më pëlqen si trajner. E dua atë. Por ne nuk kemi folur asnjëherë me të, drejtpërdrejt apo tërthorazi.

Unë e respektoj shumë dhe e vlerësoj shumë. Shumë gjëra kanë dalë në shtyp, por ne kurrë nuk kemi folur me të", ka thënë ai. "Problemi" për Zidane është Didier Deschamps. Fituesi i Kupës së Botës më 2018 dhe, së fundmi, i Ligës së Kombeve, trajneri aktual i Francës, ka fituar të drejtën të largohet sa herë të dojë, duke përjashtuar një fatkeqësi në Katar. Në krye që nga viti 2012, kapiteni i Francës në Kupën e

Botës 1998 mund të mbyllë një cikël me Botërorin e tij të tretë, kompeticionin e tij të pestë të madh me ekipin kombëtar. Ky do të ishte çelësi i ardhjes së Zidane në stol. Nëse pozicioni bëhet vakant, me Zidane e libër dhe i gatshëm, do të ishte e çuditshme që Federata Franceze e Futbollit të mos e mbushte boshllëkun me një nga legjendat e mëdha të futbollit francez. "Ai është një njeri që e vlerësoj. Ne nuk do ta përcaktojmë



karrierën e tij si lojtar apo trajner. Zidane një ditë do të arrijë në kombëtaren franceze. Kur? Nuk e di", pati thënë vitin e kaluar Noel Le Graet, presidenti i Federatës së Futbollit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "kasolla34" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektet e 30 kasollave që do të ndërtohen në zonën kadastrale Baraianë, Podujevës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.07.2022 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Adriatik" Batllavë, komuna e Podujevës, do të organizohet debat publik nga Kompania "kasolla34" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektet e 30 kasollave që do të ndërtohen në zonën kadastrale Baraianë, Podujevës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://zoom.us/j/95803739388?pwd=MUC2MG14ZnlMQWtQM1pOYTFaWTZ1Zz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "kasolla34" Sh.p.k. Prishtinë për objektet e 30 kasollave që do të ndërtohen në zonën kadastrale Baraianë, Podujevës.

https://mmpfi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publikimet/279/publikimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Erblinë Çitaku shpall të pavlefshme Diplomën e Gazetarisë të Fakultetit të Filologjisë UP, Prishtinë, me nr. 3153.

▶ Suel Haliti shpall të pavlefshme dëftesën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Fatime Shala shpall të pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.

▶ Hasim Sinani shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

▶ Arxhend Demaj shpall të pavlefshëm dëftesat e Kl I – IX, SHFMU "Aziz Tolaj" Prizren.

▶ Amda Vula nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit 'Hajdar Dushi', Gjakovë.

▶ Klejda Llagami nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e Sh.F.M.U 'Zekirja Rexha' nga klasa e –VI-IX-të Gjakovë.

▶ Klajda Llagami nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10-11-12 si dhe diplomën dhe certifikatën e testit të maturës 'Hajdar Dushi', Gjakovë.

▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

